



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE



Jergucat më: 02.12.2025

SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE

INSPEKTOR NË NJËSINË E I.M.T-së

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Ligji nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, **Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve Mbështetëse, të Bashkisë Dropull** shpall procedurat e konkurimit për vendet e lira:

- **1 (një) Inspektor, në Njësinë e I.M.T-së, Kategoria e Pagës IV-3 / IV-4**
Lloji i diplomës “Inxhinier ndërtimi”
niveli minimal i diplomës Master Shkencor / Profesional / Bachelor

1 PËRSHKRIMI PËRGJITHËSUES I PUNËS PËR POZICIONIN E MËSIPËR ËSHTË:

1. Kryerja e inspektimeve në terren, sipas planit të miratuar dhe urdhrave të eprorëve.
2. Konstatimi i shkeljeve të mundshme në fushën e ndërtimit dhe raportimi i tyre.
3. Hartimi i procesverbaleve, njoftimeve dhe dokumentacionit shoqërues.
4. Bashkëpunimi me strukturat e tjera përkatëse të administratës.
5. Zbatimi i procedurave ligjore për pezullim, ndalim, apo masat administrative ndaj ndërtimeve të paligjshme.
6. Kryen inspektime periodike dhe të menjëhershme në terren në të gjithë territorin e Bashkisë Dropull.
7. Verifikon lejet e ndërtimit, projektet dhe përputhshmërinë e punimeve me dokumentacionin teknik.
8. Konstaton shkelje të mundshme dhe harton procesverbale, njoftime dhe dokumente të tjera zyrtare.
9. Bashkëpunon me strukturat e tjera të Bashkisë dhe me institucionet ligjzbatuese sipas nevojës.
10. Propozon masa administrative dhe ndjek ekzekutimin ligjor të tyre.
11. Respekton standardet etike dhe rregullat e funksionimit të administratës publike.

2 KANDIDATËT PËR POLIC DUHET TË PLOTËSOJNË KRITERET E VEÇANTA:

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të kenë të kryer arsimin e Lartë;
3. Të jetë i moshës nga 23 vjeç deri në 65 vjeç;
4. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
5. Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
6. Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;
7. Preferohet të ketë punuar në policinë e shtetit dhe të mos ketë qënë i dënuar për shkelje të rënda dhe vepra penale;

3 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Bashkisë Dropull, dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/219-udhezime-dokumenta>
- Kërkesë për aplikim (me shkrim);
- Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- Çertifikatë e përbërjes familjare;
- Librezë ushtarake ose vërtetim nga dega e mobilizimit ushtarak;
- Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
- Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
- Fotokopje e librezës së punës. Motivacioni i largimit nga puna e fundit (në se është i punësuar ose ka qënë i punësuar);
- Raport mjeko-ligjor për ushtarakë;
- Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore;
- Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces hetimi)
- Vërtetim nga Gjykata (që nuk është aktualisht në proces gjyqësor)
- Vërtetim nga Drejtoria e Tatim-Taksave (që nuk është person fizik dhe juridik);
- 2 (dy) Fotografi (një copë 9 x 6 cm dhe një copë 2.5 x 3.5 cm).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë Dropull, brenda datës 10.12.2025.

4 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **15.12.2025** Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve Mbështetëse të Bashkisë Dropull, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Dropull dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet testimi. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve Mbështetëse, të Bashkisë Dropull.

5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me intervistën me gojë në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me punën;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Dropull do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stenden e Bashkisë Dropull. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet

Për sqarime të mëtejshme mund të na kontaktoni në adresën e e-mail bashkiadropull@gmail.com ose në adresën: Bashkia Dropull , Jergucat, Gjirokaster

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurimit, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqe zyrtare të Bashkisë Dropull, si dhe në stendat e Bashkisë Dropull:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

DREJTOR

Amalia Millo

